

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT
KRYETARI**

Nr. 475 Prot

Tiranë, më 22.04.2025

VENDIM

Nr. 78, datë 22.04.2025

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË SË KOMUNIKIMIT
2022-2025 DHE PËRDITËSIMIN E PLAN-VEPRIMIT NË ZBATIM TË SAJ**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; “Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së, 2023-2027”, miratuar me vendimin nr.247, datë 29.12.2022; rregulloren e brendshme “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të ndryshuar me vendimin nr. 211, datë 28.10.2024, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

- I. Zgjatjen e afatit të veprimit të Strategjisë së Komunikimit 2022-2025, miratuar me vendimin nr.138, datë 01.08.2022 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit deri në vitin 2027, me qëllim harmonizimin me “Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së, 2023-2027”, miratuar me vendimin nr.247, datë 29.12.2022.
- II. Përditësimin e plan-veprimit të zbatimit të Strategjisë së Komunikimit, miratuar me vendimin nr. 138, datë 01.08.2022 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ngritjen e grupit të punës që do të hartojë planin e veprimit të Strategjisë së Komunikimit deri në vitin 2027.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Arben Shehu

